



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE STUDENTËT
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

X 2. Informacion
X Op. FGH
M. M. M.
Nr. 170
M. 4.2.13.

Nr. 534 Prot

Tiranë më 01.02.2019

LËNDA: Përcjellje informacioni mbi mundësinë e aplikimit për bursa në kuadër të programit Erasmus + në Universitetin Çukurova në Turqi

FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA

Tiranë

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa mobiliteti për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin Çukurova në Turqi.

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Bashkëngjitur gjeni informacione të mëtejshme në lidhje me procedurën e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Të përcillet informacioni në strukturat e fakultetit tuaj, si edhe të publikohet informacioni bashkëngjitur në website-in e fakultetit tuaj.



Adresa: Sheshi "Nënë Tereza" Rektorati i UT, Tiranë, Tel: +355 4 2234663 / Fax: +355 4 22 39 81

Hapet thirrja për aplikime për bursa në Universitetin Çukurova në Turqi, për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + KA 107.

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për mësime në Universitetin Çukurova në Turqi, për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + KA107 për semestrin e dytë të vitit akademik 2018 - 2019.

Llojet e mobilitetit:

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësime;

Fushat e shkëmbimit:

- Kimi
- Matematikë dhe Statistikë;
- Shkencat e Natyrës;
- Bioteknologji;
- Administrim Biznesi;
- Ekonomiks;
- Financë;
- Mësime e Gjuhës Angleze;

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 ditë +2 ditët e udhëtimit;

Për më shumë informacion mbi Universitetin e Çukurovës ju lutemi referohuni linkut:

<https://www.cu.edu.tr/>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin për stafin (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze niveli B2);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë një mobilitet në kuadër të programit Erasmus+;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

*Plani i Mobilitetit për mësimdhënie është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinator i Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Afati për aplikim: 14 Shkurt 2019

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara në formatin PDF dhe të dërgohen në adresën iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!